




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova
Adriatik Kelmendi
Drejtör
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/269 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Klan Kosova
(Pala Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së: Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale si dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, lidhur me transmetimin e përmbajtjeve programore të cilat mund të jenë të dëmshme për fëmijë dhe të mitur. Monitorimi është bërë për 24 orë brenda një jave nga data 22 deri 28 maj 2021.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 qershor 2021 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar serialet “Kizim” dhe “Doktori i Mrekullive”, të cilat nuk i ka paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjë përkatëse.
4. KPM, po ashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse serialet “Doktori i Mrekullive” dhe “Fara e Flliq”, i ka transmetuar jashtë kohës së përcaktuar me rregullore, duke mos i kategorizuar, derisa përmbajtja e serialit “Doktori i Mrekullive” i përket kategorisë së dytë e që duhet të shoqërohet me shenjë përkatëse 10+, ndërsa përmbajtja e serialit “Fara e Flliq” i përket kategorisë së tretë dhe duhet të shoqërohet me shenjë përkatëse 14+.
5. KPM, në bazë të Raportit të monitorimit, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë transmetimit të programit për fëmijë “VIP Dado” ka bërë reklamim me ekran të ndarë dhe vendosje të produkteve.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 16 korrik 2021 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM 2013/01 dhe Rregulloren KPM-2017/07, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
7. KPM, nuk ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse pas dërgimit të Njoftimit për shkelje.
8. KPM, pas Njoftimit për shkelje ka bërë edhe një monitorim të dytë për të parë nëse Pala Përgjegjëse ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01 dhe Rregulloren KPM-2017/07. Monitorimi është bërë për datat 24, 26 dhe 27 korrik 2021 dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 6 gusht 2021 është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të transmetojë përmbajtje programore të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01, duke mos i kategorizuar, paralajmëruar dhe sinjalizuar me shenjë përkatëse. Po ashtu, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim edhe me Rregulloren KPM-2017/07, duke vendosur produkte në emisione të fëmijëve dhe duke reklamuar në ekran të ndarë.

Analiza ligjore

9. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2013/01 dhe Rregullores KPM-2017/07.
10. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 3, Kufizimet dhe obligimet e përgjithshme, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores KPM-2013/01, të cilët përcaktojnë se:

“1. Shërbyesit medial audio-vizuel nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.”

“3. Shërbyesit medial audio-vizuel të cilat transmetojnë radio/TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve të përcaktuar me këtë rregullore.”

KPM në bazë të Raporteve të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë ditëve të monitoruara ka vepruar në kundërshtim me nenet e lartcekura gjatë transmetimit të serialeve turke “Kizim”, “Doktori i mrekullive” dhe serialit vendor “Fara e Flliqt”, të cilët nuk janë transmetuar në kohë dhe në kushte të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01, po ashtu nuk i ka paralajmëruar me sinjal akustik apo tekstual dhe nuk i ka identifikuar me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre.

11. Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim edhe të nenit 6, Koha e Transmetimit, paragrafi 2 dhe 3, të Rregullores KPM-2013/01, të cilët përcaktojnë se:

"2. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 15:00 deri në ora 06:00."

"3. Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00."

KPM në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse me datën 22.05.2021 ka transmetuar serialin vendor "Fara e fliqit", të cilin e ka kategorizuar si 14+ dhe e ka transmetuar rreth orës 13:16. Ky serial transmetohet edhe me datën 24.05.2021 rreth orës 12:08, paralajmërohet si program jo i përshtatshëm për fëmijë deri në moshën 10 vjeçare si dhe më datën 28.05.2021 rreth orës 13:00 dhe 21:34. Sipas Rregullores KPM-2013/01 programet e kategorisë së dytë mund të transmetohen prej orës 15:00-06:00 dhe programet e kategorisë së tretë mund të transmetohen prej orës 22:00-06:00.

12. KPM gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse në serialet turke të transmetuara nuk i përdorë piktogramet e parapara me Rregulloren KPM-2013/01 dhe nuk i paralajmëron në fillim në mënyrë akustike dhe verbale, duke bërë shkelje të nenit 7, Shenjat dhe piktogramet, paragrafi 1 dhe 3, të cilat përcaktojnë se:

"1. Subjektet transmetuese do të përdorin piktogramet të paraqitura në Aneksin I të kësaj Rregulloreje."

"3. Para fillimit të programit dhe pas çdo ndërprerje të programit bëhet paralajmërim verbal dhe akustik."

13. KPM, po ashtu në bazë të Raportëve të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim edhe me Rregulloren KPM-2017/07, duke transmetuar emisionin "Vip Dado" me datën 22.05.2021 rreth orës 09:30 dhe 24.05.2021 rreth orës 11:29, tema e të cilit ka të bëjë me fëmijët e institucioneve parashkollore. Ky emision përmban vendosje të produkteve dhe përbën shkelje të nenit 15 paragrafi 1 si dhe në shkelje të nenit 12 paragrafi 1 të të njëjtës rregullore, duke transmetuar reklamim me ekran të ndarë gjatë këtij emisioni.

Neni 12, Reklamimi me ekran të ndarë, tele-promocioni dhe reklamimi virtual, paragrafi 1 i Rregullores KPM-2017/07, përcakton se:

"Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale..."

Neni 15, Vendosja e produkteve, paragrafi 2.2 i Rregullores KPM-2017/07, përcakton se:

"... Vendosja e produkteve do të jetë e lejueshme..."

2.2 Programet sportive dhe programet e lehta argëtuese, me përjashtim të programeve të fëmijëve."


14. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01 dhe Rregulloren KPM-2017/07. Duke u bazuar në Raportin e dytë monitorues është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të transmetojë përmbajtje programore të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01, duke mos i kategorizuar, paralajmëruar dhe sinjalizuar me shenjë përkatëse. Po ashtu, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim edhe me Rregulloren KPM-2017/07, duke vendosur produkte në emisione të fëmijëve dhe duke reklamuar në ekran të ndarë.
15. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje nën 3, paragrafi 1 dhe 3, nën 6, paragrafi 2 dhe 3 dhe nën 7 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe për shkelje të nën 12 paragrafi 1 dhe nën 15 paragrafi 2.2, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Vendim

1. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nën 30, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nën 3, paragrafi 3, dhe nën 7, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01.
2. Obligohet Pala Përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh, pas pranimit të këtij Vendimi, të bëjë kategorizimin e filmave dhe serialeve të cilat i transmeton, t'i paralajmërojë ato para fillimit me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01;
3. Obligohet Pala Përgjegjëse që, duke u bazuar në nën 3, paragrafi 5, të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrë Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellë në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi;

E drejta për ankesë

16. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nën 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nën 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



17.08.2021
Datë